

**ARJAN SHUMELI  
LULJETA MINE**

**ROLI DHE KONTRIBUTI I TERMINOLOGËVE SHQIPTARË  
NË ECURINË E PROCESIT TË TERMINOLOGJIZIMIT  
DHE SHTERMINOLOGJIZIMIT NË GJUHËN SHQIPE**

**Hyrje**

Terminologjizimi si dukuri gjuhësore *term-formuese* ka tërhequr vëmendjen e shumë terminologëve shqiptarë në shumë fusha të dijes dhe të shkencës. Puna dhe kontributi i tyre lidhet nga marrëdhëniet e ngushta që vendosen midis terminologjisë të çdo fushe dhe gjuhës së përgjithshme. Në këtë kontekst këto marrëdhënie dëshmojnë mundësitë e mëdha që zotëron gjuha shqipe në përdorimin e mjeteve të veta për të shprehur kuptime të reja dhe së dyti në afrimin e leksikut terminologjik me leksikun jo-terminologjik duke marrë për bazë gjuhën amtare. Procesi i *terminologjizimit* dhe *shterminologjizimit* në studimet e këtyre terminologëve nxjerrë në pah ‘aftësinë e gjuhës shqipe për emërtimin e dukurive dhe koncepteve të reja duke ngritur në nivel termi fjalët e zakonshme’ në shumë fusha si, *mekanikë, bujqësi, ekonomi, politikë, ushtri, fusha e së drejtës*, etj. Dihet se terminologjia funksionon brenda leksikut të gjuhës në lidhje të ngushta e në bashkëveprim me gjuhën e përgjithshme. Nga analiza që i është bërë proceseve të ndryshme të *term-formimit* rezulton se procesi i *terminologjizimit* dhe *shterminologjizimit* është i pranishëm, mjaft prodhues dhe shumë aktiv në gjuhën shqipe. Shumica e terminologëve shqiptarë (A. Kostallari, M. Samara, A. Duro, H. Pasho, Th. Feka) dhe të huaj (B. I. KarschIngrid<sup>1</sup> dhe Meyer Mackintosh<sup>2</sup>, E. Poparcea<sup>3</sup>, I. Bozděchová<sup>4</sup>) bien dakord mes tyre që procesin e ngritjes

---

<sup>1</sup> B. I. KarschIngrid, “BIK terminology”,  
<http://bikterminology.com/tag/determinologization/>

<sup>2</sup> Terminology in 2000.

<sup>3</sup> E. Poparcea, “Translator SL-TI process”. At  
<http://elenapoparcea.blogspot.com/2011/03/it-is-important-to-mention-that-in.html>

së një fjalë të zakonshme në term ta quajnë *terminologjizim*, ndërsa kalimin e një termi në nivelin e fjalës së zakonshme ta quajnë *shterminologjizim*. Krahas proceseve të mësipërme, hasim edhe rastet kur një term huazohet nga një fushë tjetër e shkencës dhe e teknikës për të emërtuar një send a dukuri të re në fushën përkatëse duke u ‘*ritermonologjizuar*’, d.m.th rasti i kalimit të termit nga një nivel në një nivel tjetër brenda sistemit tërësor terminologjik.

### **Termi dhe fjala: lëvizjet në të dyja kahet**

Çdo diskutim mbi lëvizjet (*ecejaket*) në kahe të ndryshme të fjalëve në terma (*terminologjizim*) dhe anasjelltas termave në falë (*shterminologjizim*) përlligj këtë hapësirë që i kushtohet dallimit që duhet bërë midis *termit* dhe *fjalës së zakonshme*. Tërësia e fjalëve që përbëjnë leksikun e gjuhës ndahet në *fjalë-terma* dhe *fjalë jo-terma (të zakonshme)*. Në mes këtyre dy ndarjeve nuk ka kufi të prerë, njësitë leksikore kalojnë anasjelltas nga njëra ndarje në tjetrën<sup>5</sup>. Krahasimi mes dy koncepteve të mësipërme është i përlligjur mbasi leksiku i përgjithshëm nuk është i veçuar nga leksiku special. Fjalët e zakonshme dhe termat shumë herë kanë një burim të përbashkët, saqë nuk mund të vihet një kufi i prerë midis tyre<sup>6</sup>. Ky diskutim për pikat e takimit dhe ato të ndarjes midis fjalës dhe termit imponohet nga lëvizjet e pareshtura që pësojnë fjalët si nevojë e emërtimit të koncepteve të reja. Lëvizjet kuptimore dalin si shfaqje e emërtimit, d.m.th, e ndërrimit të sendeve a të nocioneve nën të njëjtën fjalë<sup>7</sup>.

Sipas E. Vyster termat duhet të trajtohen ndryshe nga fjalët e gjuhës së zakonshme. Sipas tij puna me termat ndryshon nga puna më fjalët e përgjithshme në disa drejtime. *Së pari*, ndryshe nga leksikografia ku njësia leksikore merret si pika e nisjes, puna me terminologjinë nis nga koncepti<sup>8</sup>. Koncepti duhet të shihet në izolim dhe i shkëputur nga termi. Konceptet ekzistojnë pavarësisht termave dhe pavarësisht çdo gjuhe të veçantë.

<sup>4</sup> I. Bozděchová, *Theory of terminology and cognitive linguistics: on categorization, definition and nomination*, Slovo a slovesnost, ročník 71 (2010), číslo 3.

<sup>5</sup> A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Studime mbi leksikun, III”, Tiranë, 1989.

<sup>6</sup> F. Leka, *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe*, Studime mbi leksikun III, Tiranë, 1989.

<sup>7</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984.

<sup>8</sup> Eugen Wüster, *Terminologielehre und terminologische Lexikographie*, Wien, 1979.

*Dallimi i dytë*, sipas Vyster, është se terminologët janë të interesuar vetëm tek fjalori dhe tek emërtimi i koncepteve. Atyre nuk u intereson teoria e morfologjisë, apo e sintaksës. Ky lloj informacioni mund të sigurohet nga rregullat e gjuhës së përgjithshme. Fakti se morfologjia dhe sintaksa duhet të qëndrojnë jashtë çdo diskutimi, tregojnë se Vyster i perceptoi termat si njësi gjuhësore të shkëputura nga fjalët, që ndryshojnë jo vetëm në kuptimin e tyre por edhe në natyrën e përdorimit të tyre<sup>9</sup>.

Për terminologë të ndryshëm, nocioni i *termit* lidhet me ato njësi leksikore që kanë një referencë specifike në një fushë të kufizuar të dijes (Sager); termi mund të jetë një simbol gjuhësor për një koncept (ISO, Faber); termi mund të jetë ekuivalent i shenjës gjuhësore: një kombinim i shenjës dhe shënjesit (Sosyri). Termi shërben për të shprehur një koncept të caktuar brenda një sistemi konceptor. Duke u lidhur pas një koncepti, termi vihet në vartësi të koncepteve, të cilat hyjnë në marrëdhënie mes tyre duke ruajtur kuptimin e veçantë brenda çdo konteksti, d.m.th një kuptim të cilin termi e ka në sistemin e koncepteve<sup>10</sup>. Dallimi kryesor është se termat përdoren në një fushë të specializuar, ndërsa fjalët e zakonshme përdoren në më shumë se një fushë. Pra termi *'disketë'* përdoret në teknologjinë e informacionit, *'bimë'* në agronomi, *'frezë'* në agromekanikë etj. Një dallim tjetër thelbësor për qëllimin e studimit është se termat kanë një kuptim (konceptin bazë) të pranuar dhe të fiksuar (të mbrojtur), ndërsa fjalët e zakonshme një kuptim të lirë. Pra lidhjet midis konceptit dhe termit janë lidhje të tipit *një-për-një*. Pra shenja *'plug'* qëndron për një koncept të pranuar dhe të fiksuar në fushën e agromekanikës që nuk mund të interpretohet në një fushë tjetër edhe kur ajo thuhet jashtë kontekstit. Kjo ndihmon komunikimin dhe heq çdo paqartësi në kuptim. Ndërsa fjala *'grykë'* e thënë jashtë kontekstit nënkupton edhe *grykën* e njeriut, edhe *grykën* e shishes, edhe *grykën* e lumit, edhe *grykën* e pushkës etj.

Disa terminologë dallojnë tri kategori termash: (1) terma shumë teknikë, (2) terma teknikë, si dhe (3) terma gjysmë-teknikë. Për termat teknikë thuhet se çdo fushë e specializuar ka termat e vetë teknikë, si p.sh, agromekanika, *plug-frezë-kultivator-autokombajnë*, mjekësia, *sëmundje-operacion kirurgjikal-mpiksje e gjakut etj*. Termat teknikë janë pjesë e *bankës së termave*, ku shumë disiplina mund të tërheqin termat e tyre. P.sh., termi *"disk"* përdoret në fushën e sportit në kuptimin *"pllakë e rrumbullakët prej druri, e mbështjelle për qark me një rreth metali, e cila*

---

<sup>9</sup> J. Pearson, *Terms in context*, John Benjamins Publishing House, 1998.

<sup>10</sup> J. Thomai, *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989.

*kapet larg nga atletët; ai përdoret si term teknik në agromekanikë në kuptimin “pjesë e një aparati, e një makine a e një mekanizmi, e cila ka trajtën e një pjate, të një sfere të shtypur nga të dyja anët ose të një rrethi; çdo gjë që ka një trajtë të tillë”;* ai përdoret në muzikë me kuptimin “*pllakë gramafoni*”, si dhe në ushtri me kuptimin “*kuti e rrumbullakët prej metali, që shërben për të mbajtur fishekët e mitralozit*”<sup>11</sup> etj. Ndërsa termat *gjysmë-teknikë*, që janë edhe terma, edhe fjalë të zakonshme, fitojnë kuptime të veçanta në fusha të ndryshme shkencore dhe teknike. Shembuj të termave gjysmë-teknikë janë fjalët *bërthamë, fluks, thikë, kunj, bisht*, etj. Kjo është kategoria më me interes për terminologun, por kriteret e të qenit pjesë e kësaj kategorie mund të ndryshojnë. Shumë nga këto fjalë bëhen pjesë e kategorisë së termave shumë teknikë, disa bëhen pjesë e bankës së termave teknikë dhe të tjerët krijojnë një kategori tjetër të quajtur ‘nënteknikë’ vetëm dhe vetëm se këta terma përdoren në gjuhën e zakonshme. Pavarësisht statusit të tyre si fjalë të leksikut të përgjithshëm, këto terma në kontekste të veçanta konsiderohen si fjalë teknike të standardizuara, sepse specialistët që punojnë në këto fushë u caktojnë atyre një kuptim specifik brenda një fushe të dhënë. Si përfundim, mund të themi se termat e standardizuar, ose krijohen enkas për fushën specifike ku zënë vend, ose huazohen nga një fushë tjetër e dijes dhe e shkencës, apo nga gjuha e përgjithshme. Sipas Yang (1986) midis *termave specifike* të fushës dhe *termave nënteknikë* ka një dallim të dukshëm. Të dytat janë terma që ‘shprehin nocione që i përkasin shumicës së fushave’. Termat teknikë, që ai identifikon në korpusin e anglishtes teknike, janë: *absolut, saktësi, elektrik, fakt, faktor, rezultat, tipar* etj.<sup>12</sup>

### **Rrugët e realizimit të procesit të terminologjizimit**

Terminologjizimi lidhet me çdo akt, me çdo proces të futjes në terminologji të një termi, apo një grupi termash, të cilat lidhen në sistem me terminologjinë përkatëse. Rrugët kryesore të terminologjizimit përfshijnë:

(1) **krijimi i termit përmes procesit të termëzimit** si, p.sh., *bisht, dhëmb, krah, lugë/*, ku shënohet koncepti (i objektit). Kështu mund të krahasohen dy koncepte të shprehura nga e njëjta fjalë dhe mund të gjykohe për fjalën apo për termin në bazë të përmbajtjes (funksionit) dhe

<sup>11</sup> *Fjalori i shqipës së sotme* (1980).

<sup>12</sup> H. Yang, *A new technique for identifying scientific/technical terms and describing science texts (an interim report)*. Literary and linguistic computing, 1 (2), 930103, 1986.

formës së këtyre dy koncepteve objektivë. Këtu kemi rastin nga *krahu 1* (i njeriut) tek *krahu 2* (i ekskavatorit)

(2) **marrja nga fusha të tjera i termit fjalë dhe futja në sistem për emërtimin e koncepteve të tjera të fushës si:** *arkë e plehut*, *arkë e farës* (nga arkë në sistemin bankar); *fole* si pjesë e aparatit shpërndarës (fole e fishekut – usht. etj).

(3) **terma të huazuar nga gjuhë të tjera** si p.sh., *exhektor* (i shpërndarësit të plehut); *depozitë lëngjesh* etj.

(4) **marrja nga leksiku special i cili ngrihet në sistem** dhe që terminologjizohet për shkak të ndryshimit të konceptit, si zhvillim brenda fushës. Realisht këto terma, që terminologjizohen brenda fushës, shërbejnë si terma të fushës si *sfurk<sub>1</sub>-sfurk<sub>2</sub>*; *lopatë<sub>1</sub>.lopatë<sub>2</sub>*; *shoshë<sub>1</sub>-shoshë<sub>2</sub>* etj.

### **Shfaqje të shterminologjizimit në gjuhën shqipe**

Kalimi ose shtrirja e përdorimit të një njësie shënuese nga periferia në qendër ose nga mikrogjuha e shkencës dhe e teknikës në gjuhën e përgjithshme lidhet pjesërisht me humbjen e statusit terminologjik të termit. “Shkalla në të cilën një *shenjë* (fjalë ose frazë) është ‘*terminologjike*’ është në përpjestim të drejtë me sasinë e informacionit që kërkohet për ta kuptuar atë”. Në anën tjetër, duhet pasur parasysh që përfshirja ose jo në fjalor e termave kërkon që të njihet historia e zhvillimit të njohurive të ndryshme shkencore-teknike, si dhe historia e gjuhës. Si rregull, leksiku terminologjik ka një përdorim më të kufizuar krahasuar me leksikun jotermnologjik, ose leksikun e përgjithshëm. Mund të vërhet se një ‘varg termash tekniko-shkencor i kanë kaluar mjaft kufijtë e përdorimit të një rrethi të ngushtë specialishtësh’. Kështu, terma të caktuar nuk mbeten brenda caktit të përdorimit të kufizuar profesional, por përdoren nga një masë më e gjerë, duke u afruar kështu me leksikun e përgjithshëm.

Brenda leksikut terminologjik veçohet ajo pjesë e leksikut (*termat*), të cilët kanë përdorim më të gjerë se pjesa tjetër që përdoret vetëm nga një rreth i ngushtë specialistësh të një dege të shkencës, teknikës a të prodhimit. Në këtë këndvështrim, këta terma që shprehin nocione më të përgjithshme teknike si *aparat*, *arkë*, *bllok* afrohen më shpejt me leksikun e përgjithshëm e të zakonshëm të gjuhës, prandaj përfshihen në fjalësin e fjalorit shpjegues e me karakter të shqipes<sup>13</sup>. Pra në këtë kuptim, termat shpëputen nga kuptimi i tyre i ngurtë brenda një fushe të caktuar, ku

---

<sup>13</sup> Th. Feka, “Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, tek Leksiku –III, 1989: 585.

kuptohen dhe përdoren në kuptimin e tyre të specializuar nga specialistë të fushës së dhënë duke fituar një kuptim të gjithanshëm nga një masë e gjerë njerëzish.

### **Riterminologjizimi si proces i krijimit të termave të rinj**

Shpesh është e dobishme që kuptimin e modifikuar të një termi ta lidhim me një term koncept që shënohet nga i njëjti term i një fushë tjetër, sidomos në rastin kur fusha nga ku është huazuar termi të jetë e pozicionuar sa më larg fushës në fjalë për të shmangur çdo paqartësi në kuptim. Një term i tillë, që përdoret në fushën e dhënë, por që rezulton i ardhur nga një fushë tjetër quhet ‘*term i transferuar*’<sup>14</sup>. Sipas E. Çabej<sup>15</sup> zbulimi i kuptimit të fjalëve është i lidhur ngushtësisht me mjedisin e formimit të fjalëve, pranë ‘*gjeografisë*, pra ‘*sociologjia e saj*’. Nga fusha e mjekësisë është huazuar në fushën e agromekanikës duke u riterminologjizuar termi ‘*tub ushqyes*’ në kombinimin e tipit ‘*tub ushqyes*’ tek makinat dezinfektuese të drithit; Nga sistemi bankar është riterminologjizuar fjala ‘*depozitë*’ në kombinimin e tipit ‘*depozitë*’ e pluhurit tek makinët dezinfektuese të drithit; apo ‘*arka e drithit tek autokombajnë*; *depozitë e benzinës tek blloku i cilindrave* etj. Nga fusha e mekanikës së përgjithshme është huazuar fjala ‘*elevator*’ si ‘*pjesë e makinës së dezinfektimit të drithit*; bashkë me fjalën ‘*transportier i drithit tek makinë dezinfektuese e drithit*; ‘*filtrë*; *levat e ngritjes dhe uljes së brazdareve*.

### **Kontributi i terminologëve shqiptarë në ecurinë e kalimit të fjalëve në terma dhe anasjelltas**

Fjalët dhe termat janë pjesa më e lëvizshme e gjuhës. Këto lidhen me zhvillimet dhe lëvizjet në shtresat leksikore në përgjithësi, si dhe me ndryshime në përmbajtjen e fjalës dhe termit. Sipas J. Thomait lëvizjet në kuptimin e fjalëve ndodhin për shkak se sendet e dukuritë e natyrës ndryshojnë në vetvete me cilësitë e tyre karakteristike, të veçanta dhe të përbashkëta<sup>16</sup>. Disa sende dhe dukuri, veç anëve të ndryshme, kanë edhe anë të përbashkëta që na mundësojnë ne t’i emërtojmë me të njëjtën fjalë

---

<sup>14</sup> H. Felber, *Basic principles and methods for the preparation of terminology standards*, tek “Standardization of Technical Terminology: principles and Practices. Heyman, 1983.

<sup>15</sup> E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, 1982: 51.

<sup>16</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984.

(term). P.sh, duke u mbështetur në një apo disa cilësi të fjalës ‘krah’, ajo përdoret si *krahu i zogut, krahu i mizës, krahu i shkollës, krahët e skuadrës së futbollit, krahu i vinçit, krahu i autokombajnës, krahu i ekskavatorit* etj.

Në analizën që i bënë lëvizjes kuptimore të fjalëve në veprën “*Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*” (1984) J. Thomai përdor termin ‘ngushtimi i kuptimit’ për procesin e terminologjizimit, i cili ndodh kur fjalët kalojnë nga përdorimi i përgjithshëm në një fushë më të ngushtë, kryesisht gjatë krijimit të termave të shkencave të ndryshme. Ai jep rastin e fjalëve ‘nyje’ tek *nyja e drurit, nyja e gjalmit* dhe *nyja në gramatikë; mënyra*” e veprimit dhe *mënyra dëftore a lidhore në gramatikë*. J. Thomai në të njëjtën vepër përdor përkufizimin “*zgjerim kuptimi*” në vend të procesit të *shterminologjizimit*, i cili ndodh zakonisht kur fjalët kalojnë nga një fushë e ngushtë përdorimi (nga një profesion, krahinë, stil) në një fushë më të gjerë (në përdorim të përditshëm, në gjuhën letrare). Si shembuj ai sjell fjalën ‘brez’ me kuptimin ‘*rrip i gjatë prej leshi që lidhin njerëzit anës belit*’ dhe ‘*brez gjeografik, brez i njerëzve*, apo fjalën ‘shtresat’ me kuptimin ‘*rrobat që shtrohen për të fjetur*’ dhe *shtresat e tokës, shtresat shoqërore* etj. Në vazhdim, J. Thomai dallon edhe ‘*ndërrimin e kuptimit*’, i cili ndodh gjatë zhvillimit historik të gjuhës, kur fjala humbet kuptimin e parë dhe fiton një kuptim të ri. Marrëdhëniet ndërmjet gjuhës së përgjithshme e terminologjisë qëndrojnë në atë që gjuha jep materialin e domosdoshëm për emërtimin e nocioneve, fjalën, e cila me strukturën e saj kuptimore bënë të mundur të emërtohet një koncept i ri- në këtë mënyrë terminologjia funksionon brenda leksikut të gjuhës<sup>17</sup>. Sipas E. Poparcea ‘terminologjizimi është një nga format më prodhuese të termave të rinj nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve ekzistuese të gjuhës. Sipas një përlllogaritjeje të saj rezulton se terminologjizimi kontribuon me 70 % në krijimin e termave të rinj krahasuar me termat ekzistues, ndërsa shterminologjizimi me rreth 23 % dhe riterminologjizimi me 7 %.

A. Kostallari në punimin e tij “*Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*” (Leksiku III, 1989: 23-24) “pas analizës që i bënë ndarjes midis termit dhe fjalës së zakonshme, arrin në përfundimin se në gjuhën tonë vihen re dy procese të përkundërta. Në njërin anë, terminologjia depërton mjaft gjerë nga të ashtëquajturat ‘mikrogjuhë’ a ‘nëngjuhë’ të shkencës dhe të teknikës në gjuhën e përgjithshme të masave punonjëse, domethënë terminologjia *shterminologjizohet*. Nga ana tjetër njësi të

---

<sup>17</sup> H. Pasho, *Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*, “Studime filologjike”, nr. 1, 1984, f. 68.

leksikut të përgjithshëm terminologjizohen. A. Kostallari sjell shembuj të shumtë të gjuhës së përgjithshme të popullit si *bërthamë, bisht, ballë, bosht, gërshërë, rrënjë, thelb, vesh, xhep*, të cilat janë kthyer tashmë në terma në fusha të ndryshme të shkencës, të teknikës, të artit, të sportit, të ushtrisë dhe që shërbejnë si terma prodhuese për terminologjinë. Krahaso p.sh fjalën ‘*bërthamë*’ si *pjesë e fortë e frytit të pemëve*’ dhe termin ‘*bërthamë*’ në botanikë, fizikë, si p.sh., ‘*bërthama e atomit*’, *energjia bërthamore*, në gjeologji – *bërthama e tokës*, në biologji *lëng bërthamor* etj.

Në studimin që i bënë veprës së Kamardës nga pikëpamja e termave të formuar prej tij, gjuhëtari V. Bici vë re se shumë fjalë të leksikut të përgjithshëm kanë fituar kuptime terminologjike. Kështu p.sh., fjala *gjuhë* përdoret në kuptimin *gjuhë toke, qafë* përdoret për *radhë shkëmbinjsh në det, rrota e qerthuljes për orbitë, brez për zonë*, etj. Po ashtu, shumë dukuri të natyrës, forma të relievit, i kanë emërtimet e tyre në gjuhën popullore. Këto fjalë janë shënuar në fjalor ashtu siç dalin në gjuhën e populli. Si shembull merren fjalët *ajëri, akulli, luca, mjegulla, shina, shira, vesa*, etj. Duke trajtuar tematikën e formimit të termave të rinj, A. Duro në punimin ‘*Lindja dhe përhapja e termave në gjuhë*’<sup>18</sup>, pranon se termi futet më lehtë në përdorim, kur është ndërkohë edhe fjalë e zakonshme në gjuhën e përgjithshme, d.m.th kur kemi të bëjmë me ngritjen në term të një fjale të zakonshme, me përdorimin e specializuar të saj në një fushë të caktuar të dijes ose të veprimtarisë njerëzore. Si shembuj autori sjell fjalë të ngritura në terma si *kokë* (buloni), *dhëmb* (rrote), *krah* (leve), *dritare* (e jashtëqitjes) etj. Në fushën e gjuhësisë Sh. Rrokaj dhe V. Bello<sup>19</sup>, krahas trajtimit të problemeve të përgjithshme të terminologjisë gjuhësore, i kushtojnë rëndësi problemit të terminologjizimit, kur shënojnë se ‘*sistemi i terminologjik i gjuhësisë mbështetet në brumin e shqipes... fjala është për terminologjizimin e fjalëve të zakonshme si, p.sh., aftësi, bërthamë, organ, pemë, shenjë, shkallë* etj.

Termet e fushë së gjuhësisë të evidentuar nga autorët e mësipërm gjejnë zbatim edhe në fushën e bujqësisë, si, *aftësi prodhuese, bërthama e farës, organ punues, pemë frutore, shkalla e mekanizimit* etj. Nga punimet në terminologjinë ushtarake përmendim H. Çipuri, sipas të cilit ‘*termat që shënojnë pjesë të një arme ose të mekanizimit të saj kanë si bazë leksikon e*

<sup>18</sup> A. Duro, *Lindja dhe përhapja e termave në gjuhë*, “Gjuha jonë”, nr. 2, 1981, f. 40-50.

<sup>19</sup> Sh. Rrokaj, V. Bello, *Mbi domosdoshmërinë e një fjalori të termave të gjuhësisë në gjuhën shqipe, tek “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe: probleme dhe detyra”*, Konferenca Shkencore, Tiranë, 2009.

zakonshëm të shqipes si, p.sh., *boshti i tytës, gojëz e shiritit, këmishë e predhës, krehër fisheku, piruni i rrëshqitësit*". Në të njëjtën frymë termat e sipërshtënuar gjejnë përdorim edhe në fushën e bujqësisë përmes "terminologjizimit" si, *boshti i qerres, gojëza e bimës, krehri si vegël për mbledhjen e gjetheve, piruni për ngritjen e peshave* etj. Në fushën e terminologjisë të së drejtës, S. Titini<sup>20</sup> (2009:233), në punimin 'Huazimet dhe shqipërimet në terminologjinë e së drejtës' duke trajtuar problemin e krijimit të termave të rinj, thekson se "fjalë të gjuhës së përgjithshme janë ngritur në nivel termi për të dhënë të njëjtin nocion me po atë saktësi e thjeshtësi siç i jep termi i huaj, si, p.sh., *hetues* për *investigues*, *shkallë* për *instancë* gjyqësori, etj". Në fushën e terminologjisë politiko-shoqërore, M. Samara në studimin "Një vështrim i leksikut politiko-shoqëror në fjalorët shpjegues"<sup>21</sup> flet për terminologjizimin e shumë fjalëve të zakonshme, për ngritjen në shkallën e termit politiko-shoqëror të fjalëve nga leksiku i përgjithshëm i gjuhës shqipe, duke sjellë shembuj të tillë si *hop* "ndryshim rrënjësor", *lart* "organet e larta të administratës", në kundërvënien më poshtë "organet e ulëta të administratës" etj. Sipas Sh. Demiraj (1979: 8), S. Frashëri ka përdorur shumë fjalë të tabanit të shqipes për të shënuar terma diturakë, shkencorë ose politiko-administrativë. Përdorimi i fjalëve të zakonshme si p.sh., *fytyrë* në fushën e gjuhësisë me kuptimin 'trajtë', *rrënjë* apo *sy* me kuptimin 'trajtë e emrit', *zë* me kuptimin 'tingull'. Duke trajtuar çështjen e formimit të termave në fushën e ekonomisë, H. Pasho sjell shembuj të përdorimit të fjalëve të zakonshme "krah" dhe "dega" në kuptimet e reja terminologjike si 'krah pune' dhe 'dega e një banke', duke nënvizuar faktin se fjalori i 1980-ës 'e ka ndjekur këtë vijë afrimi ndërmjet terminologjisë së ekonomisë e leksikut të gjuhës së përgjithshme edhe nëpërmjet pasqyrimin të një vargu termash të shqipëruar duke mbajtur qëndrim ndaj termave të huaj". Si në gjuhë të tjera, edhe në shqipe, emrat e pjesëve të trupit përdoren shpeshherë me kuptim të tejbartur si elemente të terminologjisë gjeografike si, p.sh., *gojë* për 'grykë lumi' ose *grykë* për 'ngushticë' dhe *mëngë* për 'gji' etj. (Çabej, 1979:44).

---

<sup>20</sup> S. Titini, *Huazimet dhe shqipërimet në terminologjinë e së drejtës*, Konferencë shkencore "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe: probleme dhe detyra", Tiranë, 2009.

<sup>21</sup> Shih "Studime filologjike", nr. 3, 1985, f. 65.

